



BASHKIA TIRANË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ÇERDHEVE DHE KOPSHTEVE

PROGRAMI I EDUKIMIT PËR FËMIJËT 24-36 MUAJSH
MUAJI MARS



PËR STAFIN EDUKATOR TË ÇERDHEVE PUBLIKE TË TIRANËS

Çfarë duhet të dimë për pranverën?



“Kuriozitete për stinën e pranverës dhe muajin mars”

- Stina e parë e vitit quhet pranverë. Tre muajt e pranverës janë: Marsi, Prilli dhe Maji.
- Muaji Mars lidhet me fillimin e pranverës dhe me dukurinë e çeljes së luleve, zgjimin e shumë kafshëve dhe ardhjen e shpendëve shtegtarë. Në pranverë, qielli bëhet i kaltër, ditët zgjaten dhe ora ndryshon.
- Pranvera është stina e luleve shumëngjyrëshe, koha kur ne admirojmë bukurinë e tyre dhe mbjellim fara të reja. Lulet karakteristike të pranverës janë: manushaqja, trëndafili, jargavani, zambaku, tulipani.
- Në muajin Mars, në vendin tonë, më 14 Mars, festohet “Dita e Verës”, një festë kombëtare. Gjithashtu, muaji Mars shënon dhe Festën e Mësuesve, më 7 Mars dhe Ditën e Gruas, më 8 Mars.

Tema Mujore: Pranvera

Grupmosha 24-36 muaj

Java I: Karakteristikat e stinës së pranverës

Java II: Elementet kryesore të pranverës

Java III: Frutat dhe perimet e pranverës

Java IV: Veshjet në pranverë. Numrat, ngjyrat dhe format



Tema mujore: Pranvera

| Tema Javore | Qëllimi | Koha e realizimit |
|--|---|-------------------|
| Karakteristikat e stinës së pranverës | Njohja me elementet kryesore të stinës së pranverës (moti, natyra, bimësia). | Java I |
| Elementet kryesore të pranverës | Njohja me disa elemente të stinës si: dielli, qielli, ylberi, fluturat, zogjtë, përmes punimeve të dorës dhe vizatimit. | Java II |
| Frutat dhe perimet e pranverës | Njohja e frutave dhe perimeve të stinës përmes demonstrimit dhe përgatitjes së ushqimeve. | Java III |
| Veshjet në pranverë. Numrat, ngjyrat dhe format. | Flasim për veshjet në pranverë. Mësojmë numrat, ngjyrat dhe format. | Java IV |





Shënim: Stafi edukator duhet ta realizojë sa më qartë shpjegimin dhe realizimin e aktiviteteve me qëllim përvetësimin sa më thjeshtë të njohurive nga fëmijët. Stafi edukator duhet të informojë prindërit mbi tematikën mujore/javore për të siguruar bashkëpunimin e tyre dhe diskutimin me fëmijët në shtëpi.

Tema mujore: Pranvera



Tema e Javës: Karakteristikat e Pranverës

| Java I | Rubrika | Aktivitetet | Mjetet e Punës |
|-----------------------|---|--|---|
| <p>E Hënë</p> | <p>Mirësevjen Pranverë!</p>  | <p>Përralla: “Erdhi pranvera”.</p> <p>Bisedë: Edukatorja iu shpjegon fëmijëve karakteristikat e stinës së pranverës, si: moti (i freskët/i ngrohtë), natyra (çelin lulet, pemët gjelbërohen). Pyet fëmijët si ndryshon moti në pranverë, nëse qielli është blu apo gri, si ndryshojnë pemët dhe çfarë ngjyre kanë gjethet, a çelin lulet dhe çfarë ngjyrash kanë ato.</p> <p>Shëtitje në oborr me fëmijët për të parë, prekur, mbledhur gjethë dhe lule (shoqëruar me numërimin dhe emërtimin e ngjyrave).</p> <p>Aktivitet: Krijojmë një pemë me karton dhe gjethet e mbledhura.</p> <p><i>Mbledhim fije të bardha dhe të kuqe për të krijuar verore gjatë javës për fëmijët.</i></p> | <p>Manuali i vjershave dhe këngëve Letër kartoni, gjethë, lule</p>  |
| <p>E Martë</p> | <p>Lulet dhe gjethet</p>  | <p>Kënga: “Erdhi pranvera”.</p> <p>Vjersha: « Manushaqja e vogël » Edukatorja iu tregon fëmijëve se manushqja lajmëron stinën e pranverës.</p> <p>Mbjellja e lules në oborr/ vazo. Edukatorët dhe fëmijët improvizojnë mbjelljen e lules.</p> <p>Vjersha: “Mos e këput lulen”.</p> <p>Krijim: Lule (me bojëra/ plastelinë). Fëmijët krijojnë forma lulësh me plastelinë ose ngjyrosin forma të përgatitura nga edukatorët.</p> <p>Përralla: “Mësime kopshtarie”.</p> | <p>Manuali i vjershave dhe këngëve Lletra kartoni, ngjitëse, lapsa, gjethë dhe lule Libri “365 rrëfenja para gjumit” (f.105).</p> |







| | | | |
|-------------------------|---|--|--|
| <p>E Mërkurë</p> | <p>Qielli dhe dielli</p>  | <p>Bisedë: Edukatorja iu flet fëmijëve për motin në pranverë. Çfarë ngjyre ka qielli? A ka re? Ç’ngjyrë kanë? Ku është qielli dhe dielli? (lart apo poshtë/afër apo larg) Çfarë ngjyre ka dielli? Si është ai? (i ngrohtë apo i ftohtë).</p> <p>Shëtitje në oborr me fëmijët (kryesisht ata 24-36 muaj) për të parë dhe për të folur për natyrën.</p> <p>Lojë energjike: Lëvizje ritmike të udhëhequra nga edukatorja.</p> <p>Punë dore me vizatim/ ngjyrosje/ punim me plastelinë/ pjata plastike: Dielli/ shiu (në varësi të kohës; si në foto).</p> | <p>Manuali i vjershave dhe këngëve Letra, bojëra, plastelinë</p>  |
| <p>E enjte</p> | <p>Krijojmë me brumë</p>  | <p>Vjersha: “Manushaqja”/ “Mimoza”/“Mos e këput lulen” Kënga: “Erdhi pranvera”</p> <p>Shëtitje në oborr: Fëmijët shoqërohen në oborr ku mbledhin gjethe dhe lule.</p> <p>Krijime me brumë: Edukatorja përgatit brumë paraprakisht. Fëmijët ngjisin lule dhe gjethe mbi të (foto). I varin në spango dhe ato thahen me kalimin e kohës dhe shërbejnë si dekor.</p> | <p>Manuali i vjershave dhe këngëve</p> <p>Brumë, lule dhe gjethe natyrale</p> |
| <p>E Premte</p> | <p>Përsëritje</p>  | <p>Përsëritje e vjershave dhe këngëve të javës. Ekspozita me punimet e javës. Ngjyrosje e formave të përgatitura përpara nga edukatorja: lule, gjethe, pemë, etj. Lojë: Vizatojmë një pemë të madhe në dysheme dhe fëmijët e mbushin me gjethe, duke i numëruar ato. Gjithashtu, shtojnë në të fruta sipas frutit të ditës (molla, portokalli; si në foto).</p> | <p>Manuali i vjershave dhe këngëve</p> <p>Lapustila, gjethe, ngjitës, fruta</p> |

Tema mujore: Pranvera







Tema e Javës: Elementet Kryesore të Pranverës




| Java II | Rubrika | Aktivitetet | Mjetet e Punës |
|----------------|--|--|--|
| E hënë | Festa e Edukatores 7 Marsi   | <p>Vjersha: «Edukatorja » Bisedë: Edukatorja iu flet fëmijëve për festën e 7 Marsit, ditën e mësuesit/ edukatorit. Rëndësia e kësaj feste për vendin tonë, si festohet. I nxit fëmijët me pyetje, duke konkretizuar me pridër të fëmijëve që punojnë mësues. Mund të ftojë një prind që është mësues/ konkretizim me foto të prindërve-mësues.</p> <p>Krijim : Lule/kartolina për edukatoret përmes pikturimit me gishta duke përdorur ngjyra të ndryshme dhe letra me ngjyra, mjete të riciklueshme, etj.</p> <p>Krijojmë muzikë duke përdorur mjete rrethanore të grupit dhe kërcejmë sipas ritmit.</p>  | <p>Manuali i vjershave dhe këngëve Bojëra, letra me ngjyra Mjete rrethanore për të krijuar tingujt (shishe plastike, mjete prej druri, metalike, etj.)</p> |
| E martë | Festa e Mamin 8 Marsi  | <p>Vjersha për mamin/ nënën/ gjyshen Biseda: Edukatorja iu flet fëmijëve për domethënien e 8 Marsit, festën ndërkombëtare të grave, dita kur ne i shprehim dashurinë mamin, gjyshes dhe grave të rëndësishme në jetën tonë, që i duam.</p> <p>Krijojmë kartolina/ lule për mamin, me mjete të riciklueshme, piktura me gishta, etj.</p> <p>Muzikë dhe kërcim.</p>  | <p>Manuali i vjershave dhe këngëve Mjete të riciklueshme, lapsa me ngjyra, letra, etj.</p> |

| | | | |
|-------------------------|--|--|---|
| <p>E Mërkurë</p> | <p>Zogjtë</p>  | <p>Bisedë: Edukatorja iu shpjegon fëmijëve se në pranverë zogjtë shtegtojnë nga vendet e tjera ku ka qënë ngrohtë dhe kthehen përsëri në vende të ngrohta, ku po vjen përsëri pranvera. Ajo iu shpjegon se ata kanë sqep, pendë, bisht, i krijojnë foletë në pemë, por edhe pranë njerëzve (në ballkonet e tyre).</p> <p>Vjersha: “Ciu-ciu zog i vogël”</p> <p>Vjersha: “Qukapiku”</p> <p>Vjersha: “Dallëndyshja”</p> <p>Krijimi i zogut me mjete të riciklueshme/ letër (foto).</p> <p>Lojë energjike: me birila/ me karrige.</p> | <p>Manuali i vjershave dhe këngëve Letra me ngjyra, birila</p>  |
| <p>E Enjte</p> | <p>Flutura</p>  | <p>Vjersha: “Flutura”</p> <p>Bisedë: Edukatorja iu tregon fëmijëve për fluturat, të cilat mbushin lëndinat në stinën e pranverës.</p> <p>Punim dore me ngjyrosje/plastelinë: Fëmijët mësojnë të krijojnë një flutur. Edukatorja udhëheq punën. (Edukatorët mund të përdorin modelet e ilustruara në këtë material).</p> <p>Përrallë dhe improvizim: “Tri fluturat”.</p> |  |
| <p>E Premte</p> | <p>Ylberi</p>  | <p>Bisedë: Edukatorja iu flet fëmijëve për ylberin, i cili formohet kur pas shiut del dielli. Ilustron me foto/ figura të pikturuara në mure.</p> <p>Krijimi i ylberit në kartopecetë me lapustila me ngjyra ose me shirita me ngjyra (foto).</p> <p>Përsëritje e vjershave dhe këngëve të javës.</p> | <p>Manuali i vjershave dhe këngëve Kartpeceta, lapustila me ngjyra.</p>  |

Tema mujore: Pranvera
Tema e Javës: Frutat dhe Perimet e Stinës



| Java III | Rubrika | Aktivitetet | Mjetet e Punës |
|-------------------------|--|--|--|
| <p>E Hënë</p> | <p>Frutat e stinës së pranverës</p>   | <p>Bisedë: Edukatorja i tregon fëmijëve frutat e stinës, përmes demonstrimit me fruta të vërteta, forma plastike dhe libra.</p> <p>Loja: “Tabela e lotos” (me figura frutash).</p> <p>Vizatim ose ngjyrosje: “Frutat” – Fëmijët ngjyrosin forma të përgatitura më parë nga edukatorët (luleshtrydhe, manaferra, qershi).</p> <p>Lojë ekuilibri: Vizatojmë një pemë të madhe në dysheme, fëmijët ecin drejt sipas degëve dhe vendosin në majë të çdo dege nga një frut (foto).</p> <p>Kënga: “Sa i dua frutat”</p>  | <p>Manuali i vjershave dhe këngëve Fruta, fruta plastike, letra, ngjyra, ngjitës</p> |
| <p>E Martë</p> | <p>Perimet e stinës së pranverës</p>  | <p>Bisedë: Edukatorja i tregon fëmijëve perimet e stinës së pranverës, përmes demonstrimit me perime të vërteta, forma plastike dhe libra.</p> <p>Loja: “Tabela e lotos” (me figura perimesh).</p> <p>Vjersha: “Karota”</p> <p>Krijim “Pica me perime”: Hapim miellin në tavolinë/dysheme, presim copa-copa perimet dhe fëmijët përgatisin picën.</p> <p>Punë dore/ngjyrosje: “Kërpudhat”. Fëmijët ngjyrosin forma ose i krijojnë me ndihmën e edukatores.</p> | <p>Manuali i vjershave dhe këngëve Figura perimesh, miell, perime, letra, lapsa me ngjyra</p> |
| <p>E Mërkurë</p> | <p>Përgatitja e ushqimeve</p> | <p>Bisedë: Edukatorja i tregon fëmijëve kush gatuan në çerdhe dhe emërton llojet e ushqimeve që konsumojnë fëmijët në darkë. Pyet</p> | <p>Manuali i vjershave dhe këngëve</p> |




| | | | |
|------------------------|--|--|---|
| |  | <p>fëmijët cilat ushqime iu pëlqejnë më shumë. Kush gatuan në shtëpi? Po në çerdhe? Mjetet që përdorim kur gatujmë.</p> <p>Vizitë në kuzhinë: Kuzhinierja iu shpjegon si po përgatitet ushqimi i ditës.</p> <p>Loja imituese: “Bëj sikur gatuj”</p> <p>Përralla: “Byreku i mbretit”</p> | <p>Mjetet e kuzhinës, set gatimi, libri me përralla</p> |
| <p>E Enjte</p> | <p>Etika e të ngrënit</p>  | <p>Përralla: “Çfarë oreksi”</p> <p>Bisedë: Edukatorja iu shpjegon dhe iu demonstroi fëmijëve si shtrohet tavolina: vendosja e mbulesës, pecetave, gotave, pjatave dhe lugëve. Pyet fëmijët: Çfarë vendosim mbi tavolinë? (emërtohen dhe numërohen elementet). A duhet t'i ndihmojmë prindërit/ edukatorët në shtrimin e tavolinës? Çfarë duhet të bëjmë para dhe pas buke? (Të lajmë duart dhe buzët).</p> <p>Vjersha “Dreka”</p> <p>Aktivitet: Fëmijët e veshur si kuzhinierë shtrojnë tavolinën.</p> <p><i>(Të premtën do të përgatisni ëmbëlsirë)</i></p> | <p>Libri “365 rrëfenja para gjumit” (f.40). Manuali i vjershave dhe këngëve</p> <p>Miell/brumë</p> |
| <p>E Premte</p> | <p>Përgatitja e ëmbëlsirës</p>  | <p>Bisedë: Edukatorja pyet fëmijët: A ju pëlqejnë ëmbëlsirat? Emërton disa lloje ëmbëlsirash dhe i pyet fëmijët: Cilat ëmbëlsira ju pëlqejnë më shumë? Kush jua jep/ përgatit ëmbëlsirat? Çfarë ëmbëlsirash gatujmë në çerdhe? Po në shtëpi? etj.</p> <p>Loja: “Bëjmë karamelë me fletë me ngjyra”. Numërojmë karamelët.</p> <p>Aktivitet: “Përgatitja e ëmbëlsirës”: Edukatorët dhe fëmijët përgatisin një kek ose një ëmbëlsirë tjetër.</p> <p>Loja e kujtesës: Në një kuti kartoni fusim sende, fruta, perime të ndryshme; fëmija fut dorën dhe përpiqet të gjejë objektin dhe të thotë emrin e saktë (foto).</p> | <p>Manuali i vjershave dhe këngëve</p> <p>Biskota, miell/brumë, fruta dhe ëmbëlsira/letra me ngjyra dhe plastelinë për të formuar karamelët</p> |




Tema mujore: Pranvera

© **SEKTORI PSIKO-SOCIAL**



Tema e Javës: Veshjet në pranverë. Numrat, ngjyrat dhe format

| Java IV | Tema | Aktivitetet | Mjetet e Punës |
|----------------|---|--|---|
| E Hënë | Veshja e fëmijëve në pranverë  | <p>Bisedë: Edukatorja iu shpjegon fëmijëve që në pranverë vishemi me rroba më të lehta se në dimër. Më pas i pyet: <i>Si vishemi në pranverë? A veshim rroba të holla apo të trasha si në dimër? A veshim më pak apo më shumë rroba? A veshim xhupa apo xhaketa/triko/bluza?</i> Edukatorja iu shpjegon veshjet për fëmijë në stinën e pranverës.</p> <p>Ngjyrosje: “Veshjet e fëmijëve” – Fëmijët ngjyrosin forma të përgatitura më parë nga edukatorët.</p> <p>Ekspozita: Fëmijët ekspozojnë veshjet e ngjyrosura dhe emërtojnë ngjyrat dhe artikujt e veshjeve që kanë përdorur në punimet e tyre.</p> <p>Përralla: “Rrobat e reja të mbretit”</p> | <p>Manuali i vjershave dhe këngëve</p> <p>Fletë me forma për ngjyrosje, ngjyra</p> <p>Libri me përralla</p> |
| E Martë | Numrat 1-5  | <p>Bisedë: Edukatorja emërton numrat nga 1 deri në 5 dhe fton fëmijët të përsërisin numrat. Ajo pyet fëmijët dhe i ndihmon të përgjigjen: <i>Çfarë numri është ky?/ Sa këpucë janë këtu?</i> Konkretizojmë numrat përmes kategorizimit dhe numërimit të elementeve të ngjashme, për shembull, 1 bluzë, 2 çorape, 3 kopësa, 4 gota, 5 shishe.</p> <p>Kënga: “Lepuri” (kënga fillon me numrat 1, 2, 3, 4, 5).</p> <p>Përralla: “Rosaku i shëmtuar”</p> <p>Labirinhi i ngjyrave: Në dysheme ngjisim letra me ngjyra të ndryshme dhe fëmijët ndjekin një ngjyrë për të kapur një objekt në të njëjtën ngjyrë në fund të rrugës (foto).</p>  | <p>Manuali</p> <p>Lodra/ sende të ndryshme në grup</p> <p>Libri me përralla</p> <p>Letra me ngjyra, ngjitës</p> |

| | | | |
|-------------------------|--|---|--|
| <p>E Mërkurë</p> | <p>Format gjeometrike, madhësia</p>  | <p>Bisedë: Edukatorja iu demonstroi fëmijëve format e ndryshme gjeometrike përmes kubave dhe legove. Aktivitet: Edukatorët vizatojnë format e figurave gjeometrike dhe fëmijët gjejnë legot që përshtaten me to. Secili prej tyre vendos kubat/legot sipas formës/madhësisë përkatëse në fletën e vet. Fëmijët mësojnë dhe me ndihmën e edukatores krahasojnë format dhe madhësinë; emërtojnë ngjyrat. Aktivitet energjik: Edukatorja vizaton forma si rrethi, katrori, trekëndori në dysheme dhe iu kërkon fëmijëve të ecin dhe të vrapojnë sipas vijës. Lojë ndërtuese: Me kuba/ lego.</p> | <p>Kuba, lego, letra, ngjyra, lapustila</p> |
| <p>E Enjte</p> | <p>Shkojmë për piknik</p>  | <p>Lojë energjike: Me litar (në oborr). Aktivitet i orientuar: Fëmijët, nën drejtimin e edukatores mbledhin fruta për të ngrënë, lodra dhe sende të tjera, të cilat iu nevojiten për të shkuar në piknik. Përdoret shporta ose çantat, në të cilat fëmijët duhet të futin gjërat që iu duhen. Përralla: “Pikniku i Arushit Tedi”. Ngjyrosje: Fëmijët ngjyrosin forma ushqimesh të përgatitura më përpara nga edukatorja. <i>(Të premtën keni ekspozitë me veshje)</i></p> | <p>Litar, libri me përralla, fruta/ ushqime, shishe me ujë, etj.</p> |
| <p>E Premte</p> | <p>Ekspozitë me veshje</p>  | <p>Përsëritje e këngëve dhe vjershave. Ekspozita me veshje: Fëmijët zgjedhin të veshin rrobat e prindërve, personazheve të tyre të preferuar, ndonjë personazhi të frikshëm, etj. Lojëra me role (imitojmë prindërit ose personazhet). Tregojmë veshjet, bisedojmë për to. Tregojmë ngjyrat, numërojmë. Përralla: “Hirushja”. Muzikë dhe kërcim.</p> | <p>Manuali i vjershave dhe këngëve Veshje/ Kostume Libri me përralla</p> |